



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 612/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Gragjanska Iniciativa Srpska (GIS), paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor ne Mitrovicën e Veriut, për shkak të parregullsive me rastin e votimit ne ditën e zgjedhjeve te 3 nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Ankesa e ankuesit GIS përkitazi me anulimin e procesit te votimit ne tri Qendra te Votimit (QV) ne pjesën veriore te Mitrovicës, nr. 3805B, 3806B dhe 3805X, **Hidhet** si jo lëndore.

Përkitazi me qendrat tjera te votimit ne pjesën tjetër te Mitrovicës veriore, ankesa e GIS për anulimin e procesit te votimit, **Refuzohet** si e pabazuar.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga subjekti politik GIS, me të cilën pretendohet se më datën 03.11.2013 me rastin e votimit për zgjedhje lokale, në tri QV në pjesën veriore te Mitrovicës është shkatërruar materiali zgjedhor, ndërsa ne vendvotimet tjera zgjedhore nuk është kryer mbyllja e vendvotimeve (VV) e as qe është bërë numërimi, me çka është dëmtuar rëndë procesi zgjedhor dhe rregullat zgjedhore janë shkelur. Ankuesi ka kërkuar që zgjedhjet lokale ne Mitrovicën veriore të anulohen dhe këto zgjedhje të përsëriten.

PZAP-i, ka kërkuar përgjigje nga KQZ-ja lidhur me pretendimet e ankuesit për shkatërrimin e materialit zgjedhor dhe dëmtimin e procesit zgjedhor ne pjesën veriore te Mitrovicës, dhe KQZ-ja me shkresën e datës 07.11.2013, nr. 755/2, PZAP-in e ka informuar se KQZ më datën 05.11.2013 ka marrë vendim për përsëritjen e votimit në tri QV në pjesën veriore të Mitrovicës nr. 3805B, 3806B dhe 3805X, dhe rivotimi është caktuar për datën 17.11.2013.

PZAP-i shqyrtoj ankesën e ankuesit dhe shkresat e lëndës, dhe gjeti se:

Ankesa e ankuesit GIS përkitazi me anulimin e procesit të votimit në tri Qendra të Votimit (QV) në pjesën veriore të Mitrovicës, nr. 3805B, 3806B dhe 3805X, është jo lëndore, kurse përkitazi me qendrat tjera të votimit në pjesën tjetër të Mitrovicës veriore, ankesa e GIS për anulimin e procesit të votimit, është e pabazuar.

Për faktin se para marrjes së vendimit nga PZAP-i lidhur me ankesën e ankuesit, KQZ-ja zyrtarisht ka marrë vendim për anulimin e votimit në tri qendrat e lartpërmendura të votimit në Mitrovicën veriore, për shkak të dëmtimit të kutive të votimit, dhe ka vendosur për përsëritjen e votimit me datën 17.11.2013, PZAP-i gjen se ankesa e ankuesit përkitazi me anulimin e votimit për këto tri QV tani është jo lëndore nga se atë që ankuesi e ka kërkuar, pozitivisht e ka pranuar KQZ-ja me vendimin e lartpërmendur, kështu që PZAP-it nuk i mbetet që për këto tri QV të shqyrtoj ankesën e ankuesit, andaj tani mungon baza dhe lënda e ankesës përkitazi me këto qendra votimi.

Kurse, përkitazi me Qendrat tjera të Votimit në Mitrovicën veriore, PZAP-i gjen se ankesa e ankuesit për anulimin e procesit të votimit, është e pabazuar, kjo nga se në ankesë nuk janë bashkangjitur prova se është dëmtuar rëndë procesi zgjedhor, dhe se janë shkelur rregullat zgjedhore, andaj në mungesë të ofrimit dhe propozimit të provave për vërtetimin e pretendimeve ankimore në këtë drejtim, ankesa e ankuesit në këtë pjesë është e pabazuar. Në kuptim të nenit 3.6 pika (c) të Rregullës dhe Procedurave të PZAP-it, ankuesi ka qene i detyruar që në ankesë të paraqesë hollësi rreth çfarë do dëshmie apo prove, ose të jap udhëzime se ku mund të gjenden ato dëshmi apo prova, për vërtetimin e pretendimeve të tij, dhe me që ankuesi nuk ka vepruar kështu rezulton se ankesa e tij në këtë pjesë është e pabazuar.

Andaj me zbatimin e dispozitës së lartpërmendur, dhe nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa në Prishtinë

Anr. 612/2013 më datën 07.11.2013



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*